



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

V E N D I M

Nr. 146 , Datë 29 / 12 / 2017

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mori në shqyrtim ankesën nr.47 Regj., datë 02.08.2017, e K.K, kundër Bashkisë Fier, me pretendimin për diskriminim për shkak të “racës¹”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

I. Parashtimi i fakteve sipas subjektit ankues.

K. K në ankesën drejtuar Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi shprehet se: “*Në lagjen tonë mungojnë kanalizimet. Ujrat e zeza derdhen në rrugën kryesore, duke u bërë burim infekzioni për fëmijët dhe për të gjithë banorët. Si banorë të kësaj lagjeje kërkojmë nga Bashkia Fier që të jetojmë si pjesa tjetër e banorëve jo romë të qytetit të Fierit. Kërkojmë që të bëhen kalalizimet në lagjen 1 Maji*”.

II. Ndrekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10 221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “*Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike,*

¹ Subjekti ankues i përket komunitetit rom. Ankesa është marrë në kuadër të “Ditëve të hapura”, organizuar nga Zyra e KMD-së, në takim me komunitetin rom/egjiptian në Lagjen “1 Maji”, Fier.

gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7 i LMD-së², në pikën 1 të tij, parashikon se: “*Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupei personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjtë apo të ngashme, në krahasim me persona të tjera apo grupe personash, përbën diskriminim”.*

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10 221/2010, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën nr.744/1 prot, datë 14.08.2017, Komisioneri i kërkoi informacion Bashkisë Fier, mbi pretendimin e ngritur në ankesën e z.K.
 - Bashkia Fier nuk solli asnjë informacion lidhur me rastin në fjalë, në afatet e parashikuara ligjore.
2. Në vijim të procedurës për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës, me datë 02.11.2017³, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, realizoi një inspektim pranë ambjenteve të Bashkisë Fier.

Grupi i inspektimit të Komisionerit⁴ u takua Nën/kryetaren e Bashkisë Fier, E. P e cila citoi se për momentin nuk mund të siguronte informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar dhe se do ta nisin të detajuar, shkresërisht përmes shërbimit postar.
3. Me shkresën me nr.8234/1 prot., datë 07.11.2017 Bashkia Fier, solli informacionin e kërkuar nga Komisioneri, por të pashoqëruar me dokumetacion provues/mbështetës.

² Shkurtesë për Ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi.

³ Në zbatim të Urdhërit nr.129, datë 06.10.2017, të Komisionerit.

⁴ Në përbushje të kërkësave të Urdhërit të Komisionerit, cituar në vendim, u paraqit në ambjentet e këtij institucionit, në mënyrë që të realizonin kërkësat e inspektimit.



Bashkia Fier informon se: "Fshati Levan është qendra e Njësisë Administrative Levan/Bashkia Fier. Ky fshat përbëhet nga disa lagje si: Fushë, Qendër, Vresht, SMT, Lagjja "1 Maji" e disa lagje të tjera periferike. Të gjitha fshatrat apo lagjet e tyre kanë marrë pjesë ose janë përfaqësuar në procesin e mbledhjes së nevojave të komunitetit dhe atë të konsultimit të buxhetit. Gjatë kohës së ish-komunës Levan dhe në vazhdimisë pas reformës territoriale, është punuar me fonde të buxhetit të shtetit dhe të ardhurat e vetë njësisë.

...Në muajin shtator të këtij viti është punuar për ndriçimin rrugor të kësaj lagjeje. Pothuajse i gjithë investimi për ndriçim që përfitoi Njësia Administrative Levan për këtë periudhë, për ndriçimin rrugor, u krye në këtë lagje.

Është punuar gjatë kësaj periudhe edhe në sistemimin e ujrave të larta pasi kjo lagje është pozicionuar në një relief të tillë që kushtet natyrore shkaktojnë gërryerje dhe shkarje dherash. Është punuar gjithashtu edhe për KUZ. Janë shtrirë tubacione dhe shërbime të tjera të kësaj natyre, por për shkak të prurjeve inerte dhe pakujdesisë së vetë banorëve ato janë bllokuar, duke dalë përkohësisht jashtë funksionit. Është dashur ndërhyrja disa herë e Drejtorisë së Shërbimeve të Bashkisë Fier për normalizimin e situatës.

...Bashkia Fier pas zbatimit të reformës territoriale trashëgoi 9 ish-komuna me 88 fshatra me problematika shumë të mëdha. Bashkia Fier gjatë gjithë punës së saj është udhëhequr e do të udhëhiqet nga parimi i ofrimit të shërbimeve për qytetarët e saj në të njëjtën cilësi dhe sasi, pa patur asnjë paragjykim apo pa diskriminuar askënd. Për Bashkinë Fier qëllimi i vetëm është ofrimi i shërbimeve dhe atje ku ato nuk janë ofruar kurrë, kjo gjithmonë mbështetur dhe në mundësitë reale që Bashkia ka".

III. Në përfundim të procedurave të shqyrtimit të ankesës dhe bazuar në dokumentacionin e administruar, Komisioneri vëren se:

Lidhur me pretendimin e ankueses se është diskriminuar nga Bashkia Fier, për shkak të racës.

Ligji "Për mbrojtjen nga diskriminimi", nen 1 sipërcituar dhe nen 3/1, parashikojnë se: "Diskriminim" është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëtin mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi".

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sankzionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të

gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët.

Gjatë shqyrtimit të ankesës e ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri kishte për synim të siguronte informacion lidhur me problematikën e ngritur në ankesën e z.K, që në fakt është një problematikë që prek të gjithë banorët e Lagjes “1 Maji”, Levan, në mënyrë që të mund të vlerësonë situatën aktuale, si dhe të vlerësonë edhe masat e ndërmarra nga ana e kësaj bashkie për ta zgjidhur atë. Informacioni i kërkuar nga Komisioneri konsistonte në:

“ 1.Informacion lidhur me problematikën e ankuesit dhe gjithë komunitetit rom të Lagjes “1 Maji”, Levan.

2. Informacion nëse Bashkia Fier ishte në dijeni të problematikës.

3. Informacion lidhur me masat e marra nga ana e Bashkisë Fier, lidhur me zgjidhjen e problematikës, si dhe nëse kishte parashikuar apo miratuar ndonjë plan investimi, i cili duhej dërguar bashkëlidhur përgjigjes nga ana e tyre, etj.

Mirëpo, nga ana e këtij institucioni, u dha informacion vetëm për situatën e përgjithshme të kësaj lagjeje, si dhe një panoramë masash të përgjithshme të ndërmarra. Në mungesë të dokumentacionit mbështetës, provues të masave të ndërmarra apo që mund të ndërmerren për përmirësimin e situatës apo hartimin e një plani afat shkurtër, afatmesëm apo afatgjatë për zgjidhjen e kësaj problematike, Komisioneri vlerëson se, Bashkia Fier ka dërguar një shkresë, e cila, në pamje të pare (“a prima facie”) duket sikur e përbush detyrimin për të dhënë informacion, por në thelb nuk i shërben hetimit administrativ.

Komisioneri ka qenë i qartë dhe i drejtëpërdrejtë në kërkesat e tij, në mënyrë që të mund të realizonte një hetim të paanshëm, objektiv dhe të arsyetuar lidhur me verifikimin dhe provimin e problematikës së sjellë në ankesë pranë KMD-së.

Nga ana tjetër, inspektorët e KMD-së shkuan në lagjen “1 Maji”, Levan, për të vëzhguar situatën e infrastrukturës rrugore, ndriçimit dhe kanalizimeve⁵. Në segmentin rrugor nga rruga nationale Fier-Vlorë për në brendësi të lagjes “1 Maji”, Levan, evidentohet se rruga ishte e shtruar, me ndriçim dhe kanalizime të përfunduara, në pjesën hyrëse të saj. **Në pjesën e parë të segmentit rrugor ishin bërë investime, ndërsa në pjesën vijuese të rrugës, përparrë banesave të pjesëtarëve të komunitetit rom, u konstatua se rruga ishte e pashtuar, pa ndriçim dhe pa kanalizime. Në këtë aks rrugor ekzistonin disa shtylla ndriçimi, por që nuk ishin funksionale.**

⁵ Referuar procesverbalit të mbajtur nga inspektorët e KMD-së, me datë 02.11.2017, i cili ndodhet i depozituar në dosjen e ankuesit.



Bashkia Fier thjesht i ka kthyer një përgjigje Komisionerit⁶, por nuk i ka dhënë informacionin e kërkuar prej tij, (plan investimi për këtë lagje apo projekte dhe afat të përcaktuar për realizimin e tyre). Komisioneri nuk është njojur me asnjë dokumentacion ku të provohen masat e ndërmarra apo të parashikuara për t'u përmbushur për shtrimin e rrugës në këtë lagje apo për sigurimin e ndriçimit rrugor.

Komisioneri duke mos patur informacion për buxhetin e dhënë për lagjen “1 Maji”, Levan dhe lagjet e tjera (me banorë jo romë) apo për planin e investimit, projekte të parashikuara, etj, nuk mund të përdorë elementin krahasues, në mënyrë që të konstatojë nëse masat e ndërmarra apo buxheti i përcaktuar kanë qenë proporcionale me nevojat dhe kërkesat për ndërhyrje në këtë lagje.

Kodi i Procedurës Administrative, i ndryshuar, ka saktësuar se barra e provës në çështjet e diskriminimit të pretenduar, i kalon palës tjetër/organit publik, në këtë rast Bashkisë Fier. Pra, në këtë rast Bashkia Fier duhet të provonte se lagja “1 Maji”, Levan nuk është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme (për shkak të racës) se lagjet e tjera ku banojnë komunitet jo romë.

Kështu, neni 82, pika 2 e tij, përcakton se: “*Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj*”.

Në këto rrethana, Komisioneri mbështetet kryesisht në evidentimin në terren të situatës aktuale, gjë që është përshkruar mësipër dhe në fakt nuk është kundërshtuar as nga ana e Bashkisë Fier (fakti që rruga është e pashtuar).

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative, edhe sa i takon dhënes së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: “*Organë publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të janë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjore në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre*”.

Nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë marrë të gjitha masat që subjekti kundër të cilit është bërë ankesa të vihet në dijeni për ankesën e bërë dhe i janë ofruar mundësitë

⁶ Referuar shkresës me nr.8234/1 prot., datë 07.11.2017, të Bashkisë Fier.



që të jepte shpjegime, informacion dhe dokumentacion provues mbi pretendimet e ngritura nga subjekti ankues.

Komisioneri konstaton se subjekti ndaj të cilit është paraqitur ankesa, nuk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar, mbi problematikën e ngritur, në mënyrë që të provonte deklarimet e shprehura në shkresën me nr.8234/1 prot., datë 07.11.2017.

Neni 85 “Mosparaqitja e provave”, në pikën 2 të tij ka parashikuar se: “*Mungesa e përgjigjes ndaj njoftimit mund të merret në konsideratë për qëllimet e të provuarit, në përputhje me rrethanat e çështjes...* ”.

Në përfundim Komisioneri konstaton se nga ana e Bashkisë Fier nuk është përbushur detyrimi ndaj këtij komuniteti, lidhur me shërbimet që ato duhet t'u ofrojnë atyre.

Ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, në nenin 23 të tij ka përcaktuar funksionet e bashkive në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike. Kështu në pikat 1,2,3,4,5, të këtij nen specifikohet ndër të tjera se: “*Në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, bashkitë janë përgjegjëse në territorin e juridikacionit të tyre për:*

- 1. Prodhimin, trajtimin, transmetimin dhe furnizimin me ujë të pijshëm.*
- 2. Mbledhjen, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura.*
- 3. Mbledhjen dhe largimin e ujërave të shiut dhe mbrojtjen nga përmbytjet në zonat e banuara.*
- 4. Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve vendore dhe sinjalizimit rrugor, të trotuareve dhe shesheve publike vendore.*
- 5. Ndriçimin e mjediseve publike... ”*

Duke mos iu ofruar shërbimin e nevojshëm dhe të parashikuara në ligj, nuk është respektuar e drejta për një shërbim sa më dinjitoz, të paanshëm dhe të barabartë me të gjithë qytetarët e Fierit, pa dallim race.

Bashkia Fier i ka diskriminuar banorët e lagjes “1 Maji” Levan, përfshirë edhe ankuesin, duke shkelur parashikimet e bëra në pikën 1, të nenit 7, të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi” e cila parashikon se: “*Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupei personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjtë ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjera ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim*”.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi është autoriteti garantues i nenit 18 të Kushtetutës të RSH-së ku parashikohet parimi i barazisë sipas të cilit të gjithë qytetarët duhet të jenë të



Adresa: Rruga Sami Frasheri, Nr.10, Kati II, Tiranë
 (Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
 Tel: +355 4 2431078
 Fax: +355 4 2431077
 e-mail: info@kmd.al
 web: www.kmd.al

barabartë përpara ligjit, jo vetëm për të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë, por edhe në të drejtat e tjera ligjore.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 3, 4, 7, pika 1, nenin 20, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërmë a), si dhe nenin 33, pikat 1, 3, 5, 7 të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit për shkak të racës, të K. K, nga ana e Bashkisë së Fierit.
2. Rekomandohet Bashkia e Fierit të marrë masa për rregullimin e situatës: shtrimin, ndriçimin dhe kanalizimet e lagjes “1 Maji”, Levan, Fier.
3. Në referim të nenit 33, pika 11, të Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim, Bashkia Fier, të njoftojë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e tij.
4. Moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë sipas parashikimeve të bëra në pikën 13 të po këtij nenit.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në gjykatë, brenda afateve ligjore.

Irma BARAKU

KOMISIONERI

Fusha: Shërbime

Shkaku: Racë

Lloji i vendimit: Diskriminim i drejtëpërdrejtë



Adresa: Rruga Sami Frasherit, Nr.10, Kati II, Tiranë
 (Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al